



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

### V E N D I M

**Nr. 83, Datë 03/04/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 13, datë 19.01.2018, e Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara, përfaqësuar nga Znj. A. P., ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, gjendjes shoqërore dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Bashkisë Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se nëpërmjet kërkesës së datës 06.07.2017, drejtuar Bashkisë Shkodër, Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara ka kërkuar ambiente për zhvillimin e aktiviteteve të saj. Me shkresën nr. 10762, datë 10.07.2017, Bashkia Shkodër i bën të ditur Qendrës, se mbetet në pritje të një projekti përfundimtar nga ana e saj, në të cilin të përcaktohen qartë qëllimi, objektivat, përfituesit, mundësia reale e realizimit, stafi profesionist etj. dhe vetëm në vijim do të vlerësohet hapësira e nevojshme dhe vendi i përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve. Përgjigjen e Bashkisë Shkodër, administratorja e kësaj qendre, e ka konsideruar diskriminues për shkaqet e sipërpërmendura, pasi pretendon se Bashkia Shkodër nuk jep ambiente në mungesë të donatorëve, që mbështesin Qendrën. Znj.A. P. pretendon se para dy vitesh, Kryetarja e Bashkisë ka premtuar që ambientet

do t'u jepeshin, nëse do të sigurohej leje nga Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sportit, leje, e cila është siguruar nga shoqata. Por edhe pas marrjes së lejes, kësaj shoqate nuk i është dhënë një ambient për të zhvilluar aktivitetin e saj.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Njëpërmjet shkresës nr. 175 Prot., datë 31.01.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Bashkinë Shkodër, mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 2079, datë 09.02.2018, njëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se programi i saj i shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik mbështetet në disa politika themelore ndër të cilat janë edhe mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë Shkodër me shërbime sociale, duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit, si dhe gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar apo shkaqeve të tjera.

Në zbatim të këtyre politikave, Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka filluar procesin e krijimit dhe vënies në funksion të qendrave komunitare “Për Familjen”, të cilat funksionojnë në çdo lagje të qytetit të Shkodrës, me synim shtrirjen e shërbimit komunitar në të gjithë territorin e mbuluar nga kjo bashki. Në secilën qendër komunitare ofrohen shërbime si: pritje, informim, orientim, këshillim psikologjik, këshillim juridik, referim dhe çdo shërbim tjetër specifik, sipas nevojave të rastit.

Me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve për të gjitha kategoritë vunerabël, Bashkia e Shkodrës ka ftuar organizatat partnere të shoqërisë civile për të bashkëpunuar në ofrimin e shërbimeve pranë këtyre qendrave komunitare dhe për të krijuar së bashku një model të standardizuar të shërbimit komunitar. Për një bashkëpunim sa më institucional me organizatat partnere janë arritur marrëveshje bashkëpunimi, ku shprehen qartë rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve Bashkia Shkodër ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si: UNDP, Save the Children, Terre des Hommes, Acli/Ipsia, Gruaja tek Gruaja, Malteser, Papa Xhovani XXIII, Shpresë për Botën, Eorld Vision, Code, SOS Fshatrat e Fëmijëve etj.

Për sa i përket bashkëpunimit me organizatat që ushtrojnë aktivitete specifike për personat me aftësi ndryshe, në korrik 2017, Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, për bashkëpunimin në zhvillimin e

aktiviteteve ndërgjegjësuere, rehabilituese dhe integruuese për personat me aftësi të kufizuar. Një tjetër bashkepunim i rëndësishëm është edhe ai me organizatën “Projekti Shpresa”, në ofrimin e shërbimit të shtëpi-familjeve për personat me aftësi të kufizuar pa përkujdes familjar.

Në shkresën e Bashkisë Shkodër theksohet fakti se për realizimin dhe institucionalizimin e këtyre bashkëpunimeve, Bashkia Shkodër ka nënshkruar marrëveshje bashkepunimi me shumë organizata partnere, në të cilat janë të përcaktuara qartë qëllimi, baza ligjore, roli dhe përgjegjësia e Bashkisë dhe partnerëve, qendrueshmëria, kohëzgjatja, vendi i zbatimit etj. Bashkia Shkodër shpreh gadishmërinë e saj për bashkëpunim me çdo organizatë, me synim realizimin e projekteve të cilat i drejtohen dhe nga të cilët përfitojnë grupe sociale në vështirësi ekonomike.

Referuar shkresës së sipërpërmendur, Bashkia Shkodër shprehet se ka marrë vetëm një projekt-ide nga Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, ndërkohë që pritet projekti përfundimtar, në të cilin të përcaktohen qartë qëllimi, objektivat, përfituesit, mundësia reale e realizimit etj. Në vijim, në bazë të projektit do të vlerësohet hapësira e nevojshme dhe vendi i përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve.

2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 13, datë 19.01.2018, së Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara, mbështetur në Urdhërin nr. 42, datë 23.02.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u krye inspektim pranë Bashkisë Shkodër.

Gjatë inspektimit të kryer pranë Bashkisë Shkodër, strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimit, i informuan inspektorët e Komisionerit mbi çështjet që përbënin objektin e inspektimit.

Nga informacioni i administruar gjatë inspektimit, rezulton se nuk ka kritere të përcaktuara, aq më tepër në akte nënligjore, që një OJF duhet të plotësojë, në mënyrë që të mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër, e në vijim të mund të përfitojë nga kjo e fundit, ambiente për të zhvilluar aktivitetin e saj. Sipas Z. F. V., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimit pranë Bashkisë Shkodër, Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar ka depozituar një projekt-ide, bashkëlidhur një kërkesë për vënien në dispozicion të katin të parë të shkollës 9-vjeçare “Ali Lacej”, Shkodër, në vitin 2016. Z. F. V. u shpreh se ishte e pamunduar të realizohej një gjë e tillë, pasi kati i parë i shkollës kishte klasa, ku mësonin një pjesë e nxënësve të kësaj shkolle. Ndërkohë që, nga informacioni i administruar gjatë inspektimit administrativ rezultoi se, një klasë me hyrje nga jashtë, në katin e parë të kësaj shkolle, i është vënë në dispozicion Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë. Bashkia Shkodër paguan shpenzimet operative për këtë ambient. I pyetur mbi faktin se përse Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë u është dhënë ambient në përdorim brenda Shkollës 9-vjeçare “Ali Lacej”,

ndërkohë që Qendrës Këshillimore nuk i është dhënë një mundësi e tillë, Z. F. V. u shpreh se Qendra Këshillimore kishte kërkuar të gjithë katin e parë të shkollës në fjalë, ndërkohë që Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë kishte bërë kërkesë vetëm për një klasë të kësaj shkolle, për ta përdorur si zyrë. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimit, pranë Bashkisë Shkodër u shpreh se projekt-idea e dërguar nga Znj. A. P. nuk i plotësonte kushtet për të qenë një projekt i mirëfilltë. Për sa më sipër, rezultoi se Bashkia Shkodër nuk ndjek një format standard projekti, të cilin ajo kërkon që të ndiqet për të prezantuar një projekt nga OFJ-të apo organizatat ndërkombëtare. I pyetur nëse Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë ka paraqitur një projekt të mirëfilltë pranë Bashkisë Shkodër, Z. F. V. shprehet se kjo shoqatë ka depozituar vetëm një kërkesë për pajisje më zyrë dhe në vijim është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me të. E njëjta situatë ka ndodhur edhe me Shoqatën e të Verbërve, të cilët kanë kërkuar një zyrë, brenda qytetit të Shkodrës, për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Kjo shoqatë është pajisur me zyrë, por me të nuk është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

**Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:**

**I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:**

Bashkia Shkodër ka lidhur 13 marrëveshje bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre edhe në Shqipëri, si dhe me OJF vendase. Në shumicën e këtyre marrëveshjeve, ambienti në të cilin do të realizohen aktivitetet, përcaktohet në një klauzolë të veçantë. Në bazë të dokumentacionit të administruar përgjatë procesit të shqyrtimit të ankesës rezulton se nuk ka kritere të përcaktuara në akte nënligjore, që një OJF duhet të plotësojë, në mënyrë që të mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër, e në vijim të mund të përfitojë nga kjo e fundit, ambiente për të zhvilluar aktivitetin e saj.

Nëpërmjet kërkesës së datës 15.08.2016, Znj. A. P., Kryetare e Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar i është drejtuar Bashkisë Shkodër, që kjo e fundit t'i vërë në dispozicion shoqatës që ajo drejton, katin e parë të Shkollës 9-vjeçare "Ali Lacey", në mënyrë që shërbimi që kjo Qendër u ofron individëve me aftësi të kufizuara, të kryhej në mënyrë sa më profesionale. Bashkëlidhur kërkesës në fjalë, Qendra këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar ka dërguar një draft projekt, ku parashikohen disa aktivitete dhe disiplina që do të zhvillohen për fëmijët me aftësi të kufizuar, të tilla si: terapia e të folurit, terapi e muzikës, terapia e punës e deri tek kurset e rrobaqepësisë për vajzat e kurset e punimeve të drurit për djemtë. Në draft-projekt theksohet fakti, se stafi i Qendrës me punonjësit e trajnuar në Kursin Pasuniversitar të financuar nga SNV, do të punojë vullnetarisht, deri në aprovimin e një projekti

nga donatorët. Qendra Këshillimore me mbështetjen e OSCE-së do të aplikojë në të gjitha thirrjet për projekte, sapo të merrte konfirmimin e Bashkisë Shkodër për ambientet e nevojshme.

Në përgjigje të kërkesës së kësaj Qendre, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 10762, datë 10.07.2017, ku Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, ndër të tjera informohet se: *“.....Për realizimin dhe institucionalizimin e këtyre bashkëpunimeve Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë organizata partnere, në të cilat janë të përcaktuara qartë qëllimi baza ligjore roli dhe përgjegjësia e Bashkisë dhe e partnerëve, qëndruaeshmëria, kohëzgjatja dhe vendi i zbatimit. ...Aktualisht kemi një draft projekt të prezantuar nga organizata që ju drejtoni, “Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar” dhe mbesim në pritje të projektit përfundimtar, në të cilin të përcaktohen qartë qëllimi, objektivat, përfituesit, mundësia reale e realizimit, stafi profesionist etj, dhe në bazë të projektit do të vlerësojmë hapësirën e nevojshme dhe vendin e përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve”.*

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Shkodër kërkon nga ana e Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, që të depozitohet një projekt të mirëfilltë, ku të plotësohen kriteret e sipërpërmendura dhe në vijim pas vlerësimit përkatës, procesi vijues konsiston në nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, ku do të përcaktohet edhe vendi, ku do të zhvillohet projekti dhe aktivitetet e tij.

Referuar shkresës së sipërpërmendur, rezulton gjithashtu se Bashkia Shkodër nuk e ka bërë me dije Qendrën Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, se ishte e pamundur t'i vihej në dispozicion kati i parë i Shkollës 9-vjeçare “Ali Lacej”, pasi në këtë kat zhvillohej mësim për nxënësit e kësaj shkolle, si dhe në të njëjtën kohë nuk i është bërë i ditur opsioni, që mund t'i vihej në dispozicion vetëm një klasë në këtë kat, e cila në vijim iu vu në dispozicion Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, pas depozitimit të kërkesës së saj nr. 16, datë 04.07.2017, pranë këtij institucioni.

Kërkesa e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë nuk përmban asnjë prej kriterëve që Bashkia Shkodër citon në shkresën e saj nr.10762, datë 10.07.2017, drejtuar Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar. Bashkëlidhur kësaj kërkesë, nuk ka asnjë draft-projekt, ku të përcaktohen qartë qëllimi, objektivat, përfituesit, mundësia reale e realizimit dhe stafi profesionist. Por, pavarësisht kësaj Bashkia Shkodër ka lidhur e nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 11054, datë 17.07.2017, me Shoqatën e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, duke i dhënë në përdorim edhe një klasë (me dalje nga jashtë) në katin e parë, të shkollës në fjalë.

Për sa më sipër, neni 14, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, (i ndryshuar) parashikon: “Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës së invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”. Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër ka patur detyrim ligjor për t’i siguruar ambient për zyrë kësaj shoqate, pavarësisht faktit se kjo shoqatë nuk ka paraqitur një projekt pranë këtij institucioni.

Nga procesi i shqyrtimit të ankesës rezulton, se edhe Shoqatës së të Verbërve, i është vënë në dispozicion një zyrë për të zhvilluar aktivitetin e saj, nga ana e këtij institucioni, vetëm nëpërmjet një kërkesë të thjeshtë, pa paraqitur asnjë projekt, i cili të plotësonte kriteret e kërkuara në shkresën nr. 10762, datë 10.07.2017, të Bashkisë Shkodër drejtuar Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar. Në të njëjtin kontekst, theksohet fakti se neni 13, i ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar) parashikon shprehimisht: “Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë. Ai i njeh asaj rolin aktiv në mbrotjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve. Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim. Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim”. Edhe në këtë rast, Komisioneri gjykon se Bashkia Shkodër ka plotësuar një detyrim ligjor, duke u ofruar ambiente pune për këtë shoqatë, pa zbatuar praktikën që ndiqet për shoqata dhe organizata të tjera, që operojnë në të njëjtin sektor apo në sektorë të tjerë.

Në këto kushte, për çështjen e sipërcituar, Komisioneri gjykon se Bashkia Shkodër nuk e ka ekspozuar Qendrën Këshillimore për Njerëzit me aftësi të Kufizuar para një trajtimi të padrejtë, papabarabartë e të disfavorshëm, në krahasim me shoqata apo organizata të tjera,

Por, pavarësisht sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Shkodër e ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shoqatën e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, vetëm 13 ditë pas depozitimit të kërkesës nr. 16, datë 04.07.2017, të kësaj shoqate. Ndërkohë që, konstatohet se ky institucion i ka dërguar përgjigje zyrtare, kërkesës së datës 15.08.2016, të Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, pothuajse një vit më vonë, përkatësisht në datën 10.07.2017. Gjithashtu, Komisioneri gjykon se në shkresën nr. 10762, datë 10.07.2017, Bashkia Shkodër duhet t’ia kishte bërë të ditur Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara faktin se nuk mund t’i vihej në dispozicion kati i parë i shkollës 9-vjeçare “Ali Lacej”, pasi në këtë kat zhvillohej mësim për nxënësit e kësaj shkolle, si dhe ky institucion duhej t’i ofronte asistencën e duhur kësaj qendre, për draftimin e një projekti sipas standardit të kërkuar. Në këtë konteskt, për faktet e sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se Qendra Këshillimore për Njerëzit

me Aftësi të Kufizuara është ekspozuar para një qendrimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Shkodër.

## **I. Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar.**

Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, përfaqësuar nga Znj. A. P., pretendon se diskriminohet për shkak të “aftësisë së kufizuar”, “gjendjes shoqërore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë” nga ana e Bashkisë Shkodër.

“Aftësia e kufizuar”, “Gjendja shoqërore” dhe “Përkatësia në një grup të veçantë” janë disa prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në pikën 1, të nenit 7 të ligjit të sipërpërmendur parashikohet: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

- ✓ Lidhur me pretendimin e Znj. A. P., për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Shkodër, Komisioneri gjykon se trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe disfavorizues ndaj të cilit është ekspozuar Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, nuk ka lidhje me këtë shkak, pasi si Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë ashtu edhe Qendra e drejtuar nga Znj. A. P., operojnë në të njëjtin sektor dhe ofrojnë ndihmë dhe shërbime në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” nuk për bën shkak për diskriminim të Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, nga ana e Bashkisë Shkodër.
- ✓ Lidhur me pretendimin e Znj. A. P. për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Bashkisë Shkodër, Komisioneri gjykon se në



ankesë nuk janë dhënë argumentimet përkatëse, për sa i përket lidhjes së këtyre shkaqeve me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e disfavorizues, ndaj të cilit është ekspozuar kjo shoqatë. Në e-mailin e datës 23.01.2018, drejtuar Znj. A. P., ndër të tjera Komisioneri ka kërkuar sqarime, lidhur me identifikimin e lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit të sipërpërmendur, të pretenduar nga kjo shoqatë, me shkaqet e diskriminimit. Në përgjigjen e Znj. A. P. nuk është dhënë argumentimi përkatës. Një lidhje e tillë nuk provohet edhe gjatë hetimit administrativ të ankesës. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se gjendja shoqërore dhe përkatësia në një grup të veçantë nuk përbëjnë shkaqe për diskriminimin e Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, nga ana e Bashkisë Shkodër.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, “gjendjes shoqërore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, të Qendrës Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar, nga ana e Bashkisë Shkodër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

(Shkak: aftësia e kufizuar, gjendja shoqërore, përkatësia në një grup të veçantë  
Fusha : të mira dhe shërbime)